

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 E mërkurë, 19 janar 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09:30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëdita.

7 Zonja Sekretare, paraqitni lëndën ju lutem.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar  
9 Gjykatës, kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i  
10 Specializuar kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Së pari të shohim cilët janë të pranishëm nga palët. Zoti  
14 Prokuror, shoh që keni të njëjtën përbërje si dje?

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, e vërtetë. Kemi të njëjtën  
16 përbërje, nuk ka ndryshuar asgjë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Faleminderit.

19 Edhe për Mbrojtësen e Viktimave, besoj e njëjta?

20 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve, po, kemi të  
21 njëjtin përbërje si dje.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe  
23 Avokati i Mbrojtjes?

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës, po  
25 kemi të njëjtën përbërje si dje, dhe zoti Mustafa na përcjell

1 përmes videolidhjes.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
3 mirë.

4 Zoti Mustafa, më dëgjoni mirë?

5 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, zonja Gjykatëse.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
7 mirë.

8 Për procesverbalin, ky gjykim zhvillohet përpara Trupi  
9 Gjykues numër 1.

10 Përpara se të vijojmë me dëshminë e dëshmitarit të ZPS-së  
11 me numër 4485, dua t'ju jap një informacion paraprak palëve  
12 dhe Mbrojtjes së Viktimave, sa i takon planifikimit për këtë  
13 çështje gjyqësore, si vijon:

14 Siç edhe u tha në seancën e datës 13 dhjetor të vitit që  
15 shkoi - për referencën tuaj, është në faqen 1920, rreshtat 9  
16 deri në 11 - Trupi Gjykues, në janar të vitit 2022 duhet që të  
17 nxjerrë një vendim ku paraqiten hapat e ardhshëm proceduralë  
18 të kësaj lënde. Ju informojmë se ky vendim ka të ngjarë që të  
19 dalë javën e ardhshme. Në këtë vendim do të vendosim një sërë  
20 hapash proceduralë dhe afatesh të tilla, në përputhje me  
21 Rregullat 114, 119 dhe 129 të Rregullores, duke filluar që nga  
22 mbyllja e paraqitjes së provave nga ZPS-ja, që parashikojmë ta  
23 vendosim për datën 4 shkurt, të vitit 2022, deri në  
24 Konferencën Përgatitore të Mbrojtjes dhe Konferencën për  
25 Ecurinë e çështjes për viktimat, që do të zhvillohen ose më

1 datën 17, ose 18 shkurt, të vitit 2022.

2 Kjo është e gjitha, nuk është e përcaktuar. Të shikojmë  
3 se si do të shkojë. Por në për të, këtë planifikim kemi në  
4 mendje.

5 Shumë mirë, do të vazhdojmë me dëshminë e zotit Sopi.

6 Zonja asistente e sallës, ju lutem shoqërojeni  
7 dëshmitarin të hyjë në sallë.

8 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
10 Mirëdita. Uluni, ju lutem.

11 Zoti Sopi, mirëdita, mirë se jeni rikthyer në dhomat e  
12 specializuara. Më dëgjoni?

13 DËSHMITARI: Faleminderit. Po, mirë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
15 mirë. A patët ndopak kohë të pushonit?

16 DËSHMITARI: Po, mirë shumë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të  
18 vijojmë sot me pyetjet që jua bën Avokati i Mbrojtjes. Ju  
19 rikujtoj se jeni ende në betim dhe keni detyrimin për të thënë  
20 të vërtetën. E kuptoni, zoti Sopi?

21 DËSHMITARI: Po.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti  
23 Avokat, kam vërejtur se do të përdorni rreth gjysmë ore sot  
24 për pyetjet. Shikoj që lëvizni duart. E kuptoj që është pak a  
25 shumë kaq, por sugjeroj që këtë kohë të përdorni kryesisht.

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 4

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone (Vazhdim)

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 Mund të vazhdoni.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] {nuk dëgjohet}

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

4 lutem, ndizni mikrofonin.

5 DËSHMITARI: FATMIR SOPI [Vijim]

6 Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone [Vijon]

7 Py. Mirëdita, zoti dëshmitar. Zoti dëshmitar, dje po flisnim  
8 për atë që ke e kemi quajtur kompleksi i Zllashit, që  
9 fillimisht i përkiste familjes Krasniqi. Besoj kjo ju  
10 kujtohet?

11 Pë. Po.

12 Py. Pyetja që kam është kjo: a ju kujtohet nëse ka pasur  
13 rrymë elektrike në atë kompleks në prill të vitit 1999?

14 Pë. Nuk jam i sigurt sepse probleme me rrymën ka pasur në atë  
15 kohë, pothuajse në të gjithë fshatin, aq më tepër në një  
16 shtëpi që ka -- nuk ka pasur njerëz duke banuar aty. Nuk jam i  
17 sigurt që e di këtë gjë saktë.

18 Py. Mirë. Problemet me energjinë elektrike, këto probleme,  
19 kanë lindur nga ndërhyrja e serbëve? Pra e shkaktonin ata?

20 Pë. Po, po.

21 Py. A ka pasur ndonjë central elektrik aty afër?

22 Pë. Jo, centrali më i afërt elektrik është në Obiliq.

23 Py. A ishte ky objektiv i serbëve?

24 Pë. Jo, ai ishte i menaxhuar prej serbëve.

25 Py. Problemet që ju thoni me rrymën elektrike, a erdhën nga

1 ai stacion elektrik?

2 Pë. Po qoftë nga ai stacion, apo ka mundur edhe ndërprerje  
3 për shkak të linjave ose rrjetit elektrik gjatë rrugës. Nuk  
4 jam i sigurt, për momentin në atë kohë -- në çfarë kohe ka  
5 pasur rrymë, në çfarë kohe nuk ka pasur rrymë. Nuk jam shumë i  
6 sigurt. Në kohën më të gjatë thuajse edhe na kanë lënë në  
7 terr.

8 Py. E kuptoj. Nëse do të shkonit në atë kompleks, kompleksi i  
9 Zllashit -- e kam fjalën për vendin ku i kishin shtëpitë  
10 familja Krasniqi, në mars apo në prill të vitit 1999, a do të  
11 ishte e lehtë që ju të hynit në atë kompleks?

12 Pë. Nuk di në çfarë kuptimi. Besoj nuk ka pasur telashe.

13 Py. Ajo që dua të them, a mund të hynit e të dilnit? Njerëzit  
14 a mund të hynin lirisht në atë kompleks?

15 Pë. Nuk kam njohuri, nuk di. S'ka pasur ndonjë pengesë të  
16 veçantë.

17 Py. Pra nuk kishte ndonjë pengesë, ndonjë tra, ndonjë diçka  
18 aty?

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti  
20 Avokat, dje diskutuam për këtë vendndodhje që kishte një  
21 gardh, pjesërisht. Dua që ta kemi parasysh, duhet të jeni më  
22 specifik.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, po.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,  
25 jo. Duhet të jeni më specifik, zoti Avokat, duke bërë

1 referencën edhe tek ato që janë thënë.

2 Z. VON BONE: [Përkthim]

3 Py. A kishte ndonjë pengesë e cila duhej kaluar para se të  
4 hynit në kompleks, apo mund të hyej rregullisht?

5 Pë. Nuk më kujtohet që ka pasur ndonjë pengesë. Nuk më  
6 kujtohet. Nuk e di, por -- nuk kam parasysh një gjë të tillë.  
7 Nuk kam.

8 Py. Nëse hyje në kompleks, a duhej treguar ndonjë  
9 letërnjoftim, dokument identifikimi, qoftë ju vetë apo edhe  
10 ndonjë tjetër?

11 Pë. Sigurisht, dikush që nuk ka qenë i njohur, në qoftë se  
12 dikush prej njerëzve, kalimtarë aty të rastit, ose diçka -  
13 sigurisht, në çdo bazë ushtarake ky hyje, u është kërkuar një  
14 dokument ose të prezantohej se kush ishte. Flas për bazat në  
15 të cilat kam hasur dhe kam vizituar unë.

16 Py. E kuptoj, por nëse ju vetë shkonit te kompleksi, duhej që  
17 edhe ju vetë të tregonit këtë letërnjoftim. Identifikoheshit  
18 pra vetë?

19 Pë. Në qoftë se të kërkohej, po. Por nuk ka ndodhur. Ne jemi  
20 njoh mes vedit, kemi qenë - nuk besoj që ka pasur ndonjë  
21 pengesë në qoftë se qarkullojmë në bazat tona.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh  
23 që është ngritur Prokurori në këmbë.

24 Zoti Prokuror, flisni.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, pyetja në

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 7

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone (Vazhdim)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 këtë rast duhet të jetë më specifike, se besoj se pyetja ishte  
2 e përgjithshme. Pra "a mundej kushdo që të hynte aty pa u  
3 kontrolluar" por përgjigja është ndryshe. Mbase ka të bëjë me  
4 komandantin e UÇK-së, apo me anëtarë të UÇK-së dhe kjo dallon  
5 nga popullata e përgjithshme të cilët nuk kanë qenë anëtarë të  
6 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

7 Ajo që dua që të kërkoj nga ju të nderuar Gjykatës, është  
8 që t'i kërkon Avokatit që të jetë më konkret në pyetjet e  
9 tij.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit, zoti Prokuror. Siç e kuptova unë është që  
12 dëshmitari tha se normalisht njerëzit duhej të  
13 identifikoheshin, por në rastin konkret, nëse do të ishte vetë  
14 dëshmitari që do të shkonte, mund të mos ishte nevoja që të  
15 identifikohesh.

16 Pra mendoj se në fund doli e qartë përgjigja. Megjithatë,  
17 zoti Avokat, mbajeni parasysh këtë sugjerim të zotit Prokuror.

18 Z. VON BONE: [Përkthim]

19 Py. Nëse kushdo, cilido, do të hynte aty, qoftë edhe një  
20 anëtar i panjohur i UÇK-së, ky person do të duhej të  
21 identifikohesh apo nuk ishte e nevojshme?

22 Pë. Unë besoj se në rastet të tilla, normal se do të duhej  
23 identifikuar.

24 Py. A ju kujtohet se kujt duhej t'i tregonit identifikim  
25 juve?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone (Vazhdim) Faqe 8  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Secila bazë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është  
2 mbrojtur nga anëtarët e saj të cilët kanë qenë brenda dhe ai  
3 anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që në momentin kur  
4 dikush shkon të identifikohet, është roja. Roja e objektit.

5 Py. A ju kujtohet emri i rojës?

6 Pë. Po rojet janë ndërruar çdo 8 orë.

7 Py. Kuptoj. Pra nuk njihni asnjë emër, nuk dini asnjë emër?

8 Pë. Di -- ata ushtarë të gjithë janë ndërruar. Për shembull  
9 nuk ka ruajtur vetëm njëri, nuk ka qenë roje vetëm një person.  
10 Ose vetëm katër persona. Të gjithë ushtarët që kanë qenë në  
11 një bazë të caktuar, kanë pasur për detyrë që të shërbejnë si  
12 roje në momentin kur ju vjen rendi. Domethënë të gjithë  
13 ushtarët kanë dhënë roje, që kanë qëndruar në një bazë  
14 ushtarake.

15 Py. Faleminderit shumë, zoti dëshmitar. Ju lutem të kalojmë  
16 në seancë private, të nderuar Gjykatës.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja  
18 Sekretare, të kalojmë në seancë private ju lutem.

19 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
21 jemi në seancë private.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
23 Faleminderit.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Të shpjegoj --

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A mos



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone (Vazhdim) Faqe 9  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 është më mirë që të ruajmë procedurën, të falënderoj një herë  
2 zonjën Sekretare, pastaj tua jap unë fjalën juve, sepse kështu  
3 e kemi bërë këta muaj.

4 Keni fjalën.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Desha që të kaloj një listë me  
6 emra me dëshmitarët dhe nuk desha që të komprometoja asnjë.  
7 Py. Zoti Sopi, a njihni ndonjë person me emrin [REDAKTUAR]  
8 Pë. E kam dëgjuar si emër, por gjatë luftës nuk di ta kem  
9 takuar diku. Ndoshta edhe jam takuar, mirëpo si emër edhe e  
10 kam dëgjuar gjatë luftës.

11 Py. A e dini nëse [REDAKTUAR] kishte ndonjë nofkë, që t'ju  
12 kujtohet?

13 Pë. [REDAKTUAR] Në mos gabohem, [REDAKTUAR] i kanë thënë. Në  
14 mos gaboj.

15 Py. Faleminderit shumë, zoti dëshmitar. Zoti dëshmitar, keni  
16 dëgjuar ndonjë herë një person me emrin [REDAKTUAR] [siç e  
17 thotë Avokati]?

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti  
19 Avokat, duhet të bëjmë një ndërprerje.

20 Dëshiroj që asistentja të shoqërojë dëshmitarin të dalë  
21 nga salla një moment.

22 Dua t'i shpjegoj diçka dëshmitarit, kështu që mund t'ja  
23 vini dëgjueset. I lutem dëshmitarit që të vendosë dëgjueset.

24 Zoti dëshmitar, po kërkoj që të dilni disa çaste nga  
25 salla. Nuk do të zgjasë gjatë, por e kam të nevojshme të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone (Vazhdim) Faqe 10  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 diskutoj diçka me palët dhe Mbrojtësen e Viktimave dhe për  
2 këtë është e rëndësishme që dëshmitari të mos jetë në sallë.  
3 Prandaj dhe në këtë raste është më mirë që ju të prisni  
4 jashtë. Në rregull?

5 [Dëshmitari largohet nga salla e gjyqit]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Faleminderit, zonja asistente e sallës.

8 Zoti Avokat, dëgjova që thatë -- jemi në seancë private.  
9 Thatë që doni që të kaloni një listë dëshmitarësh. Nuk duam që  
10 ky dëshmitar të jetë në dijeni se kush janë. Pra është një  
11 listë dëshmitarësh të mbrojtur, domethënë.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] E kuptoj.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbase  
14 mund ta bëni në atë mënyrë që të mos përmendni asnjë dëshmitar  
15 të mbrojtur, të kthehemi në seancë të hapur, të bëni nja dy  
16 pyetje dhe të kthehemi në seancë private prapë. Por nuk dua që  
17 të bëhet lidhja lidhur me këtë.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] E kuptoj. Në fakt nuk është listë  
19 dëshmitarësh, nuk desha të them këtë. Desha të them diçka  
20 tjetër, po as atë nuk do ta them.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
22 rregull.

23 Zoti Mustafa, keni fjalën, po.

24 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] E nderuar Gjykatëse,  
25 nuk mujta me dëgjua përgjigjen për shkak se lidhja u ndërpre,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Faqe 11

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 nuk mujta me dëgju përgjigjen e Fatmirit.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cila  
3 ishte gjëja e fundit që dëgjuat?

4 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] E dëgjova pas pyetjes  
5 të Avokatit kur tha se cila bazë -- dhe aty u ndërpre.

6 Every base of KLA [Në anglisht].

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
8 shikoj se ku mund të ketë qenë.

9 Gjëja e fundit që është në faqen 8, mund të jetë, rreshti  
10 14:

11 "Zoti Sopi, a njihni një person me emrin ..."

12 Zoti Avokat, mbase mund ta ndihmoni ju klientin tuaj.

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Faqe 7 --

14 "Secila bazë -- "

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
16 mirë atëherë. Atëherë i kërkoj -- pra bëhet fjalë që secila  
17 bazë e UÇK-së ishte e mbrojtur, këtu u ndërpre? Ju kujtohet të  
18 keni dëgjuar këtë fjalë?

19 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Jo, "e mbrojtur" s'e  
20 kam dëgjuar. Veçse kur ka filluar përgjigja "secila bazë e  
21 UÇK-së" tani është ndërprerë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A  
23 dëgjuat ndonjë gjë lidhur me atë se kujt duhet që t'i tregonit  
24 identifikim? Kujt duhej t'i identifikoheshit?

25 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Jo.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Façe 12

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
2 Atëherë duhet që të shkojmë edhe më tutje mbrapa. A ishit i  
3 pranishëm kur po diskutoja me Avokatin e Mbrojtjes dhe me  
4 zotin Prokuror sa i takon -- pra ishit? OK.

5 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
7 rregull. Dëgjuat pyetjen që "kushdo mund të hynte në bazë edhe  
8 po të ishte një anëtar i UÇK-së i panjohur, pra çdo person do  
9 të duhej që të identifikohet". Këtë e dëgjuat?

10 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ju  
12 kujtohet se kujt duhej t'i identifikoheshit. Këtë nuk e  
13 dëgjuat ju.

14 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Jo, jo --

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
16 Atëherë është faqja 7, rreshti 7 dhe zoti Avokat, ju lutem të  
17 filloni ta lexoni procesverbalin duke filluar prej aty, dhe  
18 pasi të keni mbaruar ju do të kërkoj që të dëshmitari të hyjë  
19 në sallë.

20 Keni fjalën dhe ju falënderoj paraprakisht.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua të ulem që t'i afrohem  
22 ekranit.

23 "Py. Dhe a ju kujtohet emri i një roje?"

24 "Pë. Po rojet ndërroreshin çdo tetë orë, me rend. Të  
25 gjithë e bënin".

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Faqe 13

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 "Py. Në rregull, pra nuk ku kujtohet asnjë emër i veçantë  
2 që t'ju kujtohet?

3 "Pë. Jo, nuk njoh. Nuk e di. Di që me rend e kanë bërë  
4 rojën. Nuk është se kishte një, apo katër persona, të gjithë  
5 ushtarët e vendosur në bazën përkatëse, bënin këtë detyrë kur  
6 u vinte rendi. Kështu që të gjithë ushtarët me radhë bënin  
7 rojë"

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti  
9 Avokat, ju ndërpres. Filluat në rreshtin 12, por unë siç e  
10 kuptova nga zoti Mustafa, ai nuk e dëgjoi as pyetjen e  
11 mëparshme:

12 "A ju kujtohet se kujt ju duhej që t'i identifikoheshit?"

13 Dhe pastaj përgjigja ishte:

14 "Secila bazë e UÇK-së mbrohej nga anëtarët e vet, që  
15 ndodheshin aty, kështu që anëtari, pra personit të cilit i  
16 prezantohesh, ishte roja. Roja e objektit."

17 Këtë e lexova unë. Tani mund të vazhdoni me rreshtin 20.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit.

19 Pyetja:

20 "Faleminderit shumë, zoti dëshmitar"

21 "Avokati Von Bone: Dëshiroj që të kalojmë në seancë  
22 private, të nderuar Gjykatës."

23 "Gjykatësja: Zonja sekretare, të kalojmë në seancë  
24 private, ju lutem.

25 "Sekretarja: Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Façe 14

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 private.”

2 “Gjykatësja: Faleminderit?

3 “Avokati: Të nderuar Gjykatës, thjesht për të shpjeguar -

4 -”

5 “Gjykatësja: Zoti Avokat - ”

6 “Avokati: Po --”

7 “Gjykatësja: Avokat mundet --”

8 “Avokati: Më falni -”

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Do të lexoj më ngadalë.

10 “Gjykatësja: Të ruajmë procedurën që kemi ruajtur në  
11 muajt në vijim.”

12 “Avokati: Po, kërkoj ndjesë. Të shpjegoj -- dua që të  
13 kaloj një listë dëshmitarësh, pastaj për të parë nëse janë  
14 komprometuar në ndonjë mënyrë, nëse dihen apo s’ dihen”.

15 “Zoti Sopi, e a njihni një person me emrin [REDAKTUAR]

16 “Pë. E kam dëgjuar këtë emër, por nuk e njoh, nuk e kam  
17 takuar ndonjëherë gjatë luftës. Mbase, po emri më kujtohet.”

18 “Py. Avokati e dini nëse ka pasur ndonjë nofkë?”

19 “Pë. [REDAKTUAR] Nëse nuk e kam gabim e ka pasur nofkën  
20 [REDAKTUAR]

21 “Py. Faleminderit, Zoti dëshmitar. Zoti dëshmitar, njihni  
22 ndonjë person me emrin [REDAKTUAR]

23 Gjykatësja thotë: “Zoti Avokat”.

24 Avokati thotë:

25 “Po”

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Façe 15

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Gjykatësja thotë:

2 "Na duhet që ta ndërpresim një moment"

3 Avokati thotë:

4 "Në rregull".

5 Gjykatësja thotë:

6 "I lutem asistentes së sallës që të shoqërojë dëshmitarin  
7 të dalë një moment nga salla".

8 Avokati:

9 "Në rregull".

10 Gjykatësja:

11 "Zonja asistente, ju lutem, kërkojini dëshmitarit që të  
12 vendosë dëgjueset. Dua që t'i shpjegoj diçka. I lutem që të  
13 vendosë dëgjueset.

14 Zoti dëshmitar, po kërkoj që t'ju shoqërojnë që të dilni  
15 nga salla disa çaste. Nuk do të zgjasë gjatë por më duhet që  
16 të diskutoj diçka me palët dhe me Mbrojtësen e Viktimave për  
17 të cilën mendoj se është shumë e rëndësishme që të mos jeni i  
18 pranishëm. Dhe mendoj se në këtë rast është më mirë që ju të  
19 ndodheni jashtë sallës.

20 Faleminderit, zonja asistente.

21 Zoti Avokat, dëgjova që thatë -- dhe jemi akoma në seancë  
22 private. Dëgjova që thatë që do të kalojmë një listë  
23 dëshmitarësh."

24 Avokati:

25 "Ju kërkoj ndjesë".

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Faqe 16

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Gjykatësja:

2 "Në fakt nuk duam që dëshmitarët të dinë që kush janë  
3 këta të paktët dëshmitarët e mbrojtur".

4 Avokati:

5 "Në rregull."

6 Gjykatësja:

7 "-- pra mbase mund ta bëni në atë mënyrë që të mos  
8 përmendni tani asnjë dëshmitar të mbrojtur. Mund të kthehemi  
9 në seancë të hapur, bëni nja dy pyetje të tjera dhe pastaj  
10 kthehemi përsëri në seancë private. Por unë dëshiroj që të  
11 ketë një lidhje --"

12 Avokati:

13 "Po, e kuptoj".

14 Gjykatësja:

15 "-- me këtë. Të mos bëhet lidhja me këtë që thashë unë."

16 Avokati:

17 "Po, e kuptoj. Në fakt unë do kem bërë ndonjë lapsus  
18 sepse nuk e kish fjalën për dëshmitarët. E kisha fjalën për  
19 diçka tjetër, por as atë nuk do ta them."

20 Gjykatësja:

21 "Në rregull. Shumë mirë. Mund të vazhdojmë."

22 Pastaj unë pyeta për zotin Mustafa, dhe ky është momentin  
23 kur zoti Mustafa tha - Gjykatësja thotë:

24 "Zoti Mustrafa, e keni fjalën."

25 Zoti Mustafa tha që nuk e kapi sepse ishte ndërprerë



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Façe 17

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 lidhja.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
3 rregull atëherë. Mund të vazhdojmë.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Aty është momenti kur është  
5 rivendosur lidhja me zotin Mustafa.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
7 rregull atëherë. Fillimisht do të rikthehem në seancë  
8 publike, për të --

9 Të shoqërojmë për të hyrë në sallë.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Desha të bëj ndonjë pyetje  
11 përpara.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
13 keni ju në dorë atë, por përpara se të vazhdojmë me procesin  
14 na duhet që të kalojmë një herë në seancë publike.

15 Zonja sekretare, të kalojmë në seancë publike, ju lutem.

16 [Seancë e hapur]

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
18 jemi rikthyer në seancë publike.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit shumë zonja asistente e sallës. Ju lutem

21 shoqërojeni dëshmitarin të hyjë në sallë.

22 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
24 se erdhët, zoti dëshmitar.

25 Tani Avokati i Mbrojtjes do të vazhdojë me pyetjet ndaj

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone (Vazhdim) Faqe 18  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 jush.

2 Z. VON BONE: [Përkthim]

3 Py. Zoti dëshmitar, Brigada 153 e kishte shtabin e vet në  
4 Zllash, pavarësisht në qoftë se e kishte vendin në shtëpinë  
5 tuaj ose në atë vendin afër shkollës, për momentin kjo nuk  
6 është e rëndësishme. A kishte ndonjë përfaqësues ose ndonjë  
7 përfaqësimi ose ndonjë zyrë tjetër shtesë të Brigadës 153 në  
8 Mramor? Në fshatin Mramor?

9 Pë. Me dijen time, jo.

10 Py. Faleminderit.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Tani do të doja të kalonim në  
12 seancë private, zonja Gjykatëse, në qoftë se është e mundur.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja  
14 sekretare, a mund të kalojmë në seancë private, ju lutem?

15 ~~{Seancë private}~~[Seancë e hapur]

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
17 jemi në seancë private.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
19 Faleminderit, zonja Sekretare. Zoti Avokat, e keni ju fjalën.

20 Z. VON BONE: [Përkthim]

21 Py. Zoti Sopi, a e njihni dikë me emrin [REDAKTUAR]

22 Pë. Jo.

23 Py. A e njihni një person me emrin [REDAKTUAR]

24 Pë. Jo.

25 Py. A e njihni një person me emrin [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone (Vazhdim)

Faqe 19

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

- 1 Pë. Jo.
- 2 Py. A e njihni një person me emrin [REDAKTUAR]
- 3 Pë. Person me [REDAKTUAR] e njoh, [REDAKTUAR]
- 4 [REDAKTUAR]
- 5 Py. Çfarë moshe ka mesatarisht ky person?
- 6 Pë. Nuk di. Me sa di unë është [REDAKTUAR]
- 7 [REDAKTUAR] Nëse e kam kuptuar mirë.
- 8 Py. A ke dëgjuar ndonjëherë për këtë person, për [REDAKTUAR]
- 9 [REDAKTUAR] që të ketë qenë i ndaluar, apo i kapur gjatë
- 10 periudhës së prillit të vitit 1999?
- 11 Pë. Jo.
- 12 Py. A e njihni një person me emrin [REDAKTUAR]
- 13 Pë. Jo.
- 14 Py. A e njihni një person me emrin [REDAKTUAR]
- 15 Pë. [REDAKTUAR] Jo
- 16 Py. A e njihni një person me emrin [REDAKTUAR]
- 17 Pë. Jo.
- 18 Py. A e njihni një person me emrin [REDAKTUAR]
- 19 Pë. Jo.
- 20 Py. A e njihni një person me emrin [REDAKTUAR]
- 21 Pë. Jo.
- 22 Py. A e njihni një person me emrin [REDAKTUAR]
- 23 Pë. Jo.
- 24 Py. A e njihni një person me emrin [REDAKTUAR]
- 25 Pë. Jo.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone (Vazhdim) Faqe 20  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

- 1 Py. A e njihni një person me emrin [REDAKTUAR]
- 2 Pë. Jo.
- 3 Py. A e njihni një person me emrin [REDAKTUAR]
- 4 Pë. Jo.
- 5 Py. A e njihni një person me emrin [REDAKTUAR]
- 6 Pë. Jo.
- 7 Py. A e njihni një person me emrin [REDAKTUAR]
- 8 Pë. [REDAKTUAR] Po.
- 9 Py. Si e njihni këtë person?
- 10 Pë. Ai ka qenë përgjegjës për një njësi në [REDAKTUAR]
- 11 Py. A e ke parë ti ndonjëherë këtë person në periudhën e  
12 prillit të vitit 1999 në [REDAKTUAR]
- 13 Pë. Nuk a kam parë në atë periudhë në [REDAKTUAR] sepse ai ka  
14 shërbyer në [REDAKTUAR] dhe nuk -- në atë kohë nuk a kam parë.
- 15 Py. A e ke takuar ndonjëherë këtë person pas lufte?
- 16 Pë. Pas lufte, nuk më kujtohet.
- 17 Py. Por në ndonjë pikë të caktuar kohe gjatë luftës, a ka  
18 pasur ndonjë moment gjatë luftës kur je takuar me këtë person?
- 19 Pë. Gjatë luftës ka pasur një moment kur ka kaluar popullata  
20 civile, kanë kaluar përmes pikës ku ka qenë ai i vendosur dhe  
21 në atë moment ai më ka treguar se një fluks i madh i  
22 popullatës është duke ardhur nga Prishtina në drejtim të  
23 fshatrave tona. Në atë kohë, në atë moment më kujtohet se e  
24 kam parë.
- 25 Py. Dhe ky fluksi i njerëzve që përmende ti, kur ka ndodhur?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone (Vazhdim) Faqe 21  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

- 1 Çfarë periudhe kohe ka qenë?
- 2 Pë. Ka ndodhur pas fillimit të bombardimeve të NATO-s në
- 3 Kosovë dhe në Serbi.
- 4 Py. Ishte ushtar i UÇK-së ky?
- 5 Pë. Po.
- 6 Py. A ishte ai pjesë e Brigadës 153?
- 7 Pë. Pjesë e Brigadës 153.
- 8 Py. A e ke dëgjuar ndonjëherë në qoftë se ky person është
- 9 arrestuar apo ndaluar?
- 10 Pë. Jo, kurrë.
- 11 Py. A e njeh babain e tij?
- 12 Pë. Jo.
- 13 Py. A e njihni një person me emrin [REDAKTUAR]
- 14 Pë. Jo.
- 15 Pë. Shumë faleminderit. Kam edhe disa emra të tjerë të cilët
- 16 dua që t'i kaloj me ty.
- 17 A keni dëgjuar ndonjëherë për një person me nofkën Dardan
- 18 ose Dardani?
- 19 Pë. Nuk e kam njohur.
- 20 Py. A keni dëgjuar ndonjëherë për një person që mund ta kenë
- 21 pasur nofkën Afrimi?
- 22 Pë. Afrimi? Jo.
- 23 Py. A keni dëgjuar ndonjëherë për ndonjë person me nofkën
- 24 Baftar?
- 25 Pë. Jo.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone (Vazhdim)

Faqe 22

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Py. A keni dëgjuar ndonjëherë për një person me emrin

2 [REDAKTUAR]

3 Pë. [REDAKTUAR] Kam dëgjuar.

4 Py. Çfarë ishte [REDAKTUAR] Ishte ushtar i UÇK-së?

5 Pë. Po, një [REDAKTUAR] për të cilin po mendoj unë, ka qenë  
6 ushtar i UÇK-së.

7 Py. Ku ishte i stacionuar ky [REDAKTUAR] ushtari i UÇK-së?

8 Pë. Vetëm e di se ka qenë ushtar i gueriles BIA. Ku ka qenë i  
9 stacionuar nuk e di.

10 Py. A e keni parë ju ndonjëherë këtë person në Zllash?

11 Pë. Nuk më kujtohet.

12 Py. A e di ti se çfarë pozicion kishte ky person brenda BIA-  
13 s?

14 Pë. Jo, nuk e di. Jo.

15 Py. A e njihni një person me emrin [REDAKTUAR]

16 Pë. Jo.

17 Py. A keni dëgjuar ndonjëherë për një person me nofkën  
18 Vdekja?

19 Pë. Jo.

20 Py. A keni dëgjuar ndonjëherë për një person me emrin

21 [REDAKTUAR]

22 Pë. Jo.

23 Py. A keni dëgjuar ndonjëherë për një person me emrin

24 [REDAKTUAR]

25 Pë. Jo.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone (Vazhdim) Faqe 23  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Py. A keni dëgjuar ndonjëherë për një person me emrin  
[REDAKTUAR]

2 Pë. Jo.

3 Py. A keni parë ndonjë herë apo jeni vënë ndonjë herë në  
4 dijeni të një liste njerëzish që mund të jenë arrestuar, ose  
5 mund të jenë ndaluar diku?

6 Pë. Jo, asnjëherë.

7 Py. A ka ekzistuar ndonjëherë ndonjë listë e tillë, me sa  
8 kujtoni juve, në Brigadën 153?

9 Pë. Jo, kurrë.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë faleminderit. Të nderuar  
11 Gjykatës, tani kërkoj që të kthehemi sërish në seancë të  
12 hapur.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja  
14 Sekretare, a mund të kalojmë në seancë publike, ju lutem?

15 [Seancë e hapur]

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
17 jemi në seancë publike.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
19 Faleminderit, zonja sekretare.

20 Zoti Avokat, e keni fjalën ju.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit.

22 Py. Kam dy-tre gjëra. Ju vetë personalisht, a mbanit  
23 uniformë?

24 Pë. Po.

25 Py. Çfarë lloj uniforme ishte ajo?

1 Pë. Uniformë kamuflazhi.

2 Py. A kishit ndonjë shenjë dalluese specifike, konkrete në  
3 këtë uniformë?

4 Pë. Po.

5 Py. Çfarë shenje ishte kjo?

6 Pë. Ishte shenja "Ushtria Çlirimtare e Kosovës", shkurtesa  
7 "UÇK".

8 Py. A kishte edhe një lloj logoje ose diçka tjetër, përveç  
9 germave UÇK, a kishte ndonjë logo specifike kjo shenja?

10 Pë. Po normal, ka qenë logo e veçantë, Ushtria Çlirimtare e  
11 Kosovës dhe në anën e sipërme UÇK. Edhe në krah e kemi pasur  
12 "UÇK" dhe "Ushtria Çlirimtare e Kosovës", shqiponja dy-  
13 krenare, simboli i kombit tonë, në mes.

14 Py. Shumë faleminderit. A jeni në dijeni në qoftë se të  
15 gjithë anëtarët e Brigadës 153 vishnin një uniformë të tillë  
16 dhe uniforma kishte këto shenja që na përshkruat? Pra e  
17 vishnin uniformën të plotë apo, mund të ndodhte që edhe jo?

18 Pë. I nderuar avokat, ne nuk kishim qenë ushtri e rregullt,  
19 se të kemi uniforma për secilin ushtar dhe t'i veshin të  
20 gjithë ushtarët njësoj, me uniforma. Mirëpo jemi shërby ashtu  
21 si kemi mundur dhe si kemi pasur mundësi që t'i furnizojmë me  
22 uniforma. Dikush ka pasur uniformë të plotë, dikush ka pasur  
23 pjesërisht uniformë. Dikush nuk ka pasur fare uniformë. Mirëpo  
24 uniforma e përgjithshme e cila ka ndodhur në radhët e Ushtrisë  
25 Çlirimtare të Kosovës ka qenë vullneti për luftë, për çlirimin



1 e vendit tonë. Ndërsa sa i përket uniformave, uniforma e  
2 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në shumë raste edhe është  
3 keqpërdorur. Është keqpërdorur sidomos nga forcat ushtarake  
4 paramilitare dhe militare serbe, të cilët nën uniformën e  
5 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë kryer masakra të  
6 llahtarshme. Po ja u përmend vetëm një rast të cilin e kam në  
7 mendje, kur pjesëtarë të njësiteve serbe, me uniformë të UÇK-  
8 së në Pejë hynë në një lokal të rinjve dhe i vrasin që të  
9 gjithë ata pjesëtarë të kombit të vet, pjesëtarët serbë, në  
10 mënyrë që të fajësohej UÇK-ja dhe opiniononi ndërkombëtar ta  
11 dënonte si organizatë terroriste, sepse po kryente terror,  
12 krime.

13 Ndërsa sa i përket uniformës që ne e kemi mbajtur, nuk  
14 kemi qenë krejt -- nuk kemi qenë krejt të kompletuar.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
16 kërkoh, zoti dëshmitar, që t'i jepni përgjigje pyetjes së ju  
17 bëhet dhe mos e shtjelloni shumë përgjigjen.

18 Zoti Avokat, fjala për juve.

19 Z. VON BONE: [Përkthim]

20 Py. Sa i takon pjesëtarëve të njësisë BIA, ata vishnin të  
21 njëjtën uniformë të UÇK-së siç vishte edhe pjesa tjetër e  
22 ushtarëve të UÇK-së?

23 Pë. Po.

24 Py. Domethënë nuk kishte dallim?

25 Pë. Jo.

1 Py. Faleminderit, në rregull.

2 Py. Kam disa pyetje që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

3 Në qoftë se njerëzit kishin nevojë për kujdes shëndetësor, ku

4 ndodhej godina që mund t'u ofronte atyre kujdes shëndetësor?

5 Pë. Godina ku mund të ofrohej kujdes shëndetësor ka ndodhur

6 në disa pika. Në Mramor një, në Marefc një dhe në Zllash një,

7 po ashtu edhe në fshatra të tjera ku ka pasur nevojë, ka qenë

8 i caktuar një vend ku mund t'i ofrohej ndihmë shëndetësore, në

9 qoftë se kemi pasur të plagosur ose popullatës civile, e cila

10 në atë kohë ka qenë në numër të madh në regjionin tonë.

11 Py. E kuptoj. Në qoftë se flasim për godinën mjekësore në

12 Zllash, unë dua të flasim së bashku përpara ofensivës dhe e

13 kam fjalën këtu për ofensivën e dytë. Kjo godinë mjekësore, a

14 ishte e okupuar. Domethënë ishte e okupuar nga kush, në fakt?

15 Pë. Pas ofensivës?

16 Py. Përpara. Përpara ofensivës. Kush e shfrytëzonte? Pra dje

17 thatë që pas ofensivës së dytë që ishte më 18 prill, domethënë

18 e kam fjalën për para periudhës së 18 prillit.

19 Pë. Ka qenë një vend që kemi mbajtur njerëz të sëmurë ose të

20 plagosur, ka qenë një shtëpi private, e cila sot e ka edhe

21 shenjën që ka shërbyer si vend ku janë shëruar të sëmurët ose

22 të plagosurit.

23 Py. Shumë faleminderit. Ky vend, sa larg është nga shkolla?

24 Pë. 1 kilometër.

25 Py. Dhe nëse do jesh në fillim të shkollës, a ke mundësi që

1 ta shohësh këtë vend?

2 Pë. Me sa di unë edhe mund të duket. Nuk jam shumë i sigurt.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më

4 falni. E humbëm zotin Mustafa.

5 Sot në mëngjes më duket sikur na thanë që problemet

6 teknike ishin zgjidhu por me sa duket nuk është ky rasti.

7 [Vështirësi teknike]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti

9 Mustafa, mirë se erdhët. Cila është gjëja e fundit që dëgjuat?

10 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Gjëja e fundit që

11 dëgjova është kur Fatmiri filloi të japë përgjigjen për --

12 shëndetësi, aty, ku ka qenë objekti i shëndetësisë, q'ashtu

13 diçka.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra

15 është faqja 25, rreshti 14, në faqen 25 ju thatë avokat:

16 "Kam disa pyetje, të cilat kanë të bëjnë me kujdesin

17 shëndetësor. Në qoftë se njerëzit kishin nevojë për

18 shëndetësor, ku shkonin? Kush ishte objekti që merrnin kujdes

19 shëndetësor?"

20 Pra zoti Mustafa, në këtë pikë e keni humbur lidhjen me

21 gjykatën? E keni dëgjuar, e keni ndjekur deri në këtë pikë?

22 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e nderuara

23 Gjykatëse, deri këtu. Mbas kësaj është ndërprerë --

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

25 mirë, zoti Mustafa, do t'i kërkoj avokatit që të lexojë pjesën

1 nga këtu e poshtë.

2 Zoti Avokat, a mund ta lexoni ju lutem nga faqja 25,  
3 reshti 16, deri në fund?

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Fillon  
5 me një përgjigje:

6 "Godina ku mund të merrnin kujdes mjekësor, kishte disa.  
7 Ishte një në Mramor, një në Zllash, dhe një në Marec. Në  
8 fshatra të tjerë, kurdo që ishte e nevojshme, kishte një vend  
9 të caktuar për sa i takon ofrimin të kujdesit shëndetësor në  
10 qoftë se nevojitej, në veçanti për popullsinë civile, që ishte  
11 në shifra të mëdha e pranishme në atë regjion në atë kohë."

12 "Py: E kuptoj. Dhe po të flasim për objektin mjekësor në  
13 Zllash do të donim që të flisnim bashkë në lidhje me të  
14 përpara ofensivës dhe a kam fjalën këtu për ofensivën e dytë.  
15 Kjo godinë mjekësore, nga kush në fakt shfrytëzohej?"

16 Dhe përgjigja është:

17 "Pas ofensivës e keni fjalën?"

18 Vijohet më tej:

19 "Jo, përpara ofensivës së dytë, para ofensivës së dytë,  
20 që ju thatë që ofensiva e dytë ndodhi me 18 prill. E kam  
21 fjalën për periudhën përpara 18 prillit."

22 "Pë. Kishte një vend ku ne mbanim personat e sëmurë dhe  
23 personat e plagosur. Ishte një shtëpi private."

24 "Py. E kuptoj."

25 "Pë. Dhe edhe sot e kësaj dite ka një shenjë ku thuhet që

1 kjo është shtëpia ku personat e plagosur dhe të sëmurë janë  
2 trajtuar.”

3 “Py. Faleminderit. Ky vend sa larg është nga shkolla?”

4 “Pë. Rreth 1 kilometër.”

5 “Py. Dhe në qoftë se jeni përpara shkollës, në qoftë se  
6 mund ta them kështu, a është e mundur që ta shikoni këtë  
7 vend?”

8 “Pë. Me sa di unë, mbase mund të jetë e dukshme.”

9 “Py. Faleminderit”.

10 Dhe në këtë pikë Gjykatësja na ndërpreu dhe tha që ju  
11 keni humbur lidhjen. Në këtë jemi, e nderuar Gjykatëse.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
13 mirë. Tani, zoti Mustafa dëgjoi pjesën që nuk e kishte dëgjuar  
14 më përpara kështu që besoj që mund të vijoni me pyetjet tuaja  
15 avokat.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit.

17 Py. Objekti mjekësor, ku është edhe kjo shenja në shtëpi që  
18 thatë juve, është objekti mjekësor që është përdorur pas  
19 ofensivës së dytë, për të qenë i qartë, apo --

20 Pë. Nuk jam i sigurt, kohën. Mund edhe pas ofensivës së dytë,  
21 ka vazhduar të shfrytëzohet, po.

22 Py. Shumë faleminderit. A bëheshin takime të komandantëve të  
23 Brigadës 153 përpara fillimit të ofensivave. Pamë që kishte  
24 pasur dy ofensiva. Pyetja është: në qoftë se, a janë bërë  
25 takime përpara ndodhjes së dy ofensivave, të realizuara nga

1 komanda e Brigadës 153?

2 Pë. Nuk më kujtohet, zoti Avokat.

3 Py. Si anëtar i komandës së Brigadës, si informohej komanda e  
4 komanda e Brigadës lidhur me ofensivat që priteshin ose  
5 ofensiva potenciale, të mundshme. Domethënë, si bëhej  
6 informimi i komandës së Brigadës?

7 Pë. Informimi bëhej nëpërmjet radiolidhjeve, zakonisht, sepse  
8 ne ishim të zëmë në terren dhe nuk mund që në çfarë do kohe të  
9 bashkoheshim, të takoheshim. Por konsultimet apo njoftimet,  
10 apo --bëheshin edhe nëpërmjet radiolidhjes në distanca më të  
11 largëta.

12 Py. A jeni i informuar ju nga Salih Mustafa për lëvizje të  
13 mundshme të forcave serbe në periudhën e prillit të vitit  
14 1999?

15 Pë. Nuk jam i sigurt, mund të kemi pasur edhe informata të  
16 tilla. Nuk jam i sigurt.

17 Py. Dhe këto informata që mund të keni pasur, mund të kenë  
18 qenë edhe më përpara ofensivës së dytë, që ka qenë më 18 prill  
19 të vitit 1999?

20 Pë. Mund të kemi pasur edhe normal komunikime në lidhje me  
21 ekzistencën e rrezikut të tillë. Mund të kemi pasur.

22 Py. A e dinit ju se ku gjendej zoti Mustafa në atë kohë?

23 Pë. As unë as zoti Mustafa, gjatë ofensivave dhe gjatë  
24 operacioneve luftarake, nuk kemi mundur që të qëndrojmë në një  
25 vend, sepse është dashur të merremi me pozicionimet, me

1 vjeljen e informatave dhe me përgatitjet për operacione

2 luftarake.

3 Py. Informacioni që ai ju ka dhënë juve ose njerëzve të tjerë  
4 të komandës, a e mbani mend në qoftë se ai informacion ka qenë  
5 i dobishëm?

6 Pë. Sigurisht se po.

7 Py. Sa herë e keni parë juve zotin Mustafa në Zllash?

8 Pë. Nuk më kujtohet sa herë e kam parë. Unë e kam parë shumë  
9 herë. Kemi qenë bashkëluftëtarë dhe kemi qenë në të njëjtat  
10 pozicione, në të njëjtin vend, kështu që nuk mbaj mend takime  
11 të veçanta. Kemi pasur takime rutinore të ndryshme.

12 Py. "Takime rutiore" kur thua takime rutinore, këto takime  
13 realizoheshin personalisht apo përmes radiolidhjes?

14 Pë. Edhe personalisht edhe në shtëpinë time.

15 Py. A ka pasur ndonjë periudhë të caktuar kohe kur ai ka qenë  
16 në lëvizje?

17 Pë. Në lëvizje?

18 Py. Po, që ka qenë në lëvizje. A e di se ku kishte shkuar ai,  
19 në çfarë zona kishte lëvizur?

20 Py. [E padëgjueshme] informacione. Nuk e di. Në atë kohë nuk  
21 kemi pasur informacione detal kush ku është. Pos në qoftë se  
22 është paraqitur nevoja që dikush të kërkohet, e kemi kërkuar.

23 Py. Dhe gjatë prillit të vitit 1999, të themi tre javët e  
24 para të prillit të vitit 1999, a dini nëse zoti Mustafa ka  
25 sjellë staf mjekësor, personel mjekësor për Brigadën apo për

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 32

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone (Vazhdim)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 çfarëdo lloj gjëje tjetër në Zllash. Ju kujtohet kjo?

2 Pë. Nuk më kujtohet, por atë edhe mund ta kenë bërë. Nuk më  
3 kujtohet.

4 Py. Kur qëndronte në Zllash, ku qëndronte ai?

5 Pë. Ai qëndronte më tepër në bazën Skifterat, por ka qëndruar  
6 edhe në shtëpinë time.

7 Py. Keni dijeni, sa shpesh ishte ai në Zllash në periudhën  
8 kohore nga data 1 deri në 21 prill, që e keni parë ju vetë?

9 Pë. Nuk më kujtohet.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Dhe e fundit, dëshirojmë t'i  
11 tregojmë një fotografi dëshmitarit, një fotografi që e kemi  
12 parë, me numër SPOE00128388.

13 Py. Zoti Sopi, kjo shtëpi, ku qëndron? Shohim sigurisht tre  
14 shtëpi aty, por nga e djathta në të majtë është ajo që është  
15 më e lartë, e mesme dhe një tjetër, një strukturë në të majtë.  
16 Dua me ju të flasim për ndërtesën që ndodhet në të djathtë.  
17 Çfarë është ajo ndërtesa aty?

18 Pë. Kjo, e biseduam edhe dje, është ndërtesa në shtëpinë e  
19 familjes Krasniqi.

20 Py. A e dini se për çfarë përdorej?

21 Py. Me sa di unë kjo është dhoma e pritjes së mysafirëve,  
22 dhoma e miqve.

23 Py. Ju vetë keni qenë aty ndonjëherë në atë shtëpi?

24 Pë. Kam qenë edhe si mysafir, po.

25 Py. Po gjatë prillit të vitit 1999 a keni qenë?



1 Pë. Nuk më kujtohet. Ndoshta dhe mund të kem qenë ndonjëherë,  
2 nuk më kujtohet.

3 Py. Kur shkonit ju aty, për se përdorej? Kishte ndonjë  
4 përdorim të veçantë?

5 Pë. Jo, kanë qëndruar ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të  
6 Kosovës.

7 Py. E keni fjalën që flinin aty? Ishin strehuar?

8 Pë. Po, po.

9 Py. Po ai objekti në mes, përdorej për ndonjë gjë? Në mes të  
10 fotografisë?

11 Pë. Jo, nuk besoj ky nuk -- nuk ka qenë i përdorshëm as  
12 atëherë. Nuk besoj.

13 Py. Dhe struktura, ai objekti në të majtë, a përdorej për  
14 ndonjë gjë?

15 Pë. Jo, pleme -- kjo familja e ka përdorur për ushqim  
16 bagëtish, ndërsa Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk besoj se  
17 do t'i ketë nevojitet diçka -- nuk jam i sigurt. Nuk besoj.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti  
19 Avokat, dua që të sqaroj diçka, sepse kam disa pyetje, unë  
20 vetë.

21 Për cilën periudhë po flasim tani?

22 DËSHMITARI: Unë fola çka kam mujt me ju shërbu për  
23 familjen, për periudhën e luftës nuk di, përpos për qëndrimin  
24 e ushtarëve që ka shërbyer kjo. Diçka tjetër nuk di, nuk kam  
25 njohuri. Se këto objekte janë të pashfrytëzueshme, këto pjesa

1 tjetër. ndërsa shtëpia ka shërbyer si vend ku kanë fjetur  
2 ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kështu e kam  
3 kuptuar unë edhe pyetjen.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
5 Pyetja që ju bë ishte për përdorimin e dy ndërtesave në të  
6 djathtë, pra ndërtesa majtas që është më lartë.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Në të majtë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Që  
9 janë majtas ndërtesës më të lartë. Po faleminderit, zoti  
10 Avokat. Ju vetë keni qenë në ato dy ndërtesa?

11 DËSHMITARI: Jo.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
13 Faleminderit.

14 Z. VON BONE: [Përkthim]

15 Py. Po ju pak më përpara thatë që mund të keni qenë në atë  
16 periudhë kohore aty.

17 Pë. Shtëpia lartë. Jo në objektin ku është -- nuk kanë qenë  
18 të shfrytëzueshme.

19 Py. Për të qenë të qartë, në periudhën prill të vitit 1999?

20 Pë. Jo, nuk jam i sigurt. Nuk besoj që kam qenë në atë  
21 periudhë aty.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Duhet  
23 të ndalojmë përsëri. Ju kërkoi ndjesë që ju ndërpres, zoti  
24 Avokat, më duhet të ndalojmë sepse kemi humbur lidhjen me  
25 zotin Mustafa.

1 [Vështirësi teknike]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti  
3 Mustafa, më dëgjoni?

4 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, zonja Gjykatëse.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A  
6 mund të na ndihmoni duke na thënë se deri ku po na përcillnit?

7 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, besoj se s'kam  
8 humbur shumë. Kur filloi Fatmiri me dhënë përgjigjen e dytë që  
9 e pyeti avokati, që tha më poshtë që ka qenë. Q'ashtu diçka.  
10 Kur filloi që të japë këtë përgjigjen e dytë. Kur po flasim  
11 për shpinë, aty. Nuk kam humb shumë, s'e besoj.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
13 dëgjuat pyetjen e avokatit tuaj, pyetjen që tha "dhe për të  
14 qenë të qartë, kjo ishte në periudhën prill të vitit 1999?"

15 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] E jo, prej këtu. Këtë  
16 s'e dëgjova.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po:  
18 "Jo, në objektet aty poshtë, që mendoj se nuk përdoreshin për  
19 ndonjë gjë"? këtë e dëgjuat?

20 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] E dëgjova. Po.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Atëherë do lexoj këto dy fraza unë vetë.

23 Pyetja:

24 "Për të qenë të qartë, kjo ishte në periudhën prill të  
25 vitit 1999?"

1 Përgjigja:

2 "Nuk jam i sigurt. Jo, nuk besoj të kem qenë aty gjatë  
3 asaj periudhe."

4 Dhe këtu u ndërpre lidhja.

5 Zoti Avokat, mund të vazhdoni.

6 Z. VON BONE: [Përkthim]

7 Py. Jeni vërtetë, absolutisht i sigurt që s'keni qenë në atë  
8 ndërtesë në prill të vitit 1999 ose pak më përpara se t'ju --  
9 lidhur me atë që bëmë pak më përpara, keni qenë apo jo?

10 Pë. Zoti Avokat, unë që nga 7 prilli i vitit 1999 kam qenë i  
11 ngarkuar me detyrën e komandantit të operacioneve luftarake në  
12 zonën e Prapashticës, e cila kufizohet me Serbinë. Dhe që nga  
13 ajo ditë unë vazhdimisht kam qenë atje, duke marrë pjesë në  
14 luftime. Ndërsa, ofensiva e dytë me 18 -- dhe deri në  
15 ofensivën e dytë të 18 prilli unë rrallë herë jam kthyer në  
16 Zllash. Në ofensivën e dytë, kur ka filluar me 18 prill, unë  
17 jam angazhuar në drejtimin Marec, Zllash i Vogël, Mramor dhe i  
18 kam udhëhequr operacionet e luftës atje.

19 Py. Përpara 7 prillit, jeni i sigurt që nuk keni qenë në atë  
20 ndërtesë në Zllash? Në ndërtesën që është në të djathtë të  
21 fotografisë, pra përpara 7 prillit?

22 Pë. Zoti Avokat, unë nuk më kujtohen të gjitha vendet ku kam  
23 qëndruar, me datë e me ditë. Kanë kaluar 24 vjet dhe unë nuk  
24 më kujtohet saktë kur, ku kam qenë, sepse për mua nuk ka qenë  
25 e rëndësishme ajo, sa ka qenë e rëndësishme ruajtja e

1 popullatës civile dhe prita që duhej organizuar forcave serbe.

2 Py. Faleminderit shumë, zoti Sopi.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju kërkoj një minutë.

4 [Avokatët e Mbrojtjes këshillohen midis tyre]

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë, kemi disa

6 pyetje të fundit dhe do t'i përfundojmë pyetjet tona.

7 Py. Zoti Sopi, keni dëgjuar ndonjëherë për njerëz të  
8 maltrajtohen në Zllash. Për shembull që t'ju kenë djegur qiri  
9 mbi ta? Pra keni dëgjuar ndonjëherë që të jenë maltrajtuar  
10 njerëz në Zllash, për shembull, duke i djegur me qiri?

11 Pë. Kjo më bën të qesh sepse është e pamundur dhe është diçka  
12 që nuk ka mundur të ndodhë, jo në Zllash por kurrkund.

13 Py. A keni dëgjuar ndonjëherë që tua kenë bërë këtë me shufra  
14 hekuri, t'u kenë lëshuar rrymë elektrike në trup, apo t'i kenë  
15 rrahur me shufra metalike?

16 Pë. Jo, kurrë nuk kam dëgjuar, as nuk ka mundur të ndodhi kjo  
17 kurrë.

18 Py. Faleminderit shumë. Po pse mendoni se nuk mund të ketë  
19 ndodhur?

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Që  
21 nuk mund të kenë ndodhur,

22 Z. VON BONE: [Përkthim]

23 Py. Po, po, që nuk mund të ketë ndodhur.

24 Pë. Unë i besoj të kaluarës time, të kaluarës së shokëve të  
25 mi dhe jam i bindur se nuk ka mundur askush, përderisa forcat

1 -- ekskluzivisht vetëm në qoftë se ka ndodhur kjo kur forcat  
2 serbe e kanë pushtuar Zllashin dhe kanë qëndruar vetëm një  
3 natë aty. Dhe në qoftë se në atë periudhë kanë ndodhur këto  
4 prej forcave serbe, na nuk kemi mujt me e ditë, ka mujt edhe  
5 me ndodh ajo. Përndryshe Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka  
6 zhvilluar luftë të pastër çlirimtare dhe nuk ka pasur luftë  
7 civile në mes të njerëzve por luftë çlirimtare dhe nuk ka mujt  
8 këto të ndodhin në Zllash, përpos nga forcat Serbe, në qoftë  
9 se ka ndodhur në atë periudhë kur ata kanë qëndruar në Zllash.  
10 Py. Ju kuptoj. A keni dëgjuar ndonjëherë nëse zoti Salih  
11 Mustafa ka dhënë urdhra apo vetë ai të ketë rrahur apo të ketë  
12 maltrajtu njerëz apo që të jenë trajtuar mizorisht njerëzit me  
13 ato format që unë sapo i ceka, keni dëgjuar ndonjëherë?

14 Pë. Unë Salih Mustafën e njoh edhe para lufte, e kam njohur  
15 si ish i burgosur politik dhe në liri -- i cili i ka përjetuar  
16 torturat më çnjerëzore nga pushteti serb dhe nuk e besoj kurrë  
17 se i njëjti mund të ushtrojë dhunë ndaj dikujt, për asnjë  
18 arsye dhe për asnjë rast.

19 Py. Zoti Sopi, po ndonjë tjetër, a ka përhapur informacione  
20 të tilla për Salih Mustafën, që të keni ju dijeni?

21 Pë. Jo, nuk -- edhe në atë periudhë në jetën time nuk kam  
22 dëgjuar diçka të tillë për bashkëluftëtarin tim, zotin Salih  
23 Mustafa.

24 Py. Kur bëtë takime me të në Zllash, është folur ndonjëherë  
25 për spiunë, bashkëpunëtorë apo diçka tjetër, çfarëdo në këtë

1 formë?

2 Pë. Kurrë nuk ka ekzistuar në mes nesh ajo temë, të jetë  
3 diskutuar në asnjë rrethanë.

4 Py. Brenda UÇK-së, apo brenda Brigadës, a kishte ndonjë  
5 ndarje aty, në mes të ushtarëve apo në mes të Brigadës, të  
6 personave që mbase mund të kishin ndonjë përkatësi të veçantë  
7 politike, apo që luanin ndonjë rol në atë kohë?

8 Pë. Në asnjë rrethanë dhe në asnjë formë nuk ka qenë pengesë  
9 orientimi politik i ushtarit të UÇK-së. Qëllimi i luftës ka  
10 qenë çlirimi i vendit, ndërsa për bindjet politike të askujt  
11 neve në atë kohë nuk na ka interesuar.

12 Py. Faleminderit shumë.

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Një moment.

14 [Avokatët e Mbrojtjes këshillohen midis tyre]

15 Z. VON BONE: [Përkthim]

16 Py. Kam një pyetje të fundit, zoti Sopi. Struktura e Brigadës  
17 153 a ndiqte të njëjtën strukturë organizative të Brigadave të  
18 mëparshme që ishin 151 dhe 152?

19 Pë. Besoj afërsisht ashtu.

20 Py. Mes këtyre seksioneve, a kishte edhe një seksion  
21 operacionesh? Kishte një seksion të veçantë për operacione?

22 Pë. Jo, s'kam njohuri, nuk e di.

23 Py. Kishte ndonjë seksion apo sektor të veçantë për zbulimin,  
24 apo për kundërzbulimin?

25 Pë. Jo, nuk jam i sigurt. Nuk di.

1 Py. A kishte ndonjë sektor apo njësi të veçantë për moralin  
2 dhe politikën?

3 Pë. Sigurisht në strukturë ka qenë. Qysh ka funksionuar nuk e  
4 di.

5 Py. Dhe a kishte ndonjë sektor të veçantë për mbrojtjen  
6 civile brenda Brigadës 153?

7 Pë. Po, në atë periudhë kur është strukturuar Brigada 153, ka  
8 ekzistuar një sektor i tillë.

9 Py. Dhe kush ishte në krye të kësaj?

10 Pë. Unë kam qenë vetë.

11 Py. Faleminderit shumë, zoti dëshmitar.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk kemi pyetje të tjera, të  
13 nderuar Gjykatës.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
15 Faleminderit, Avokati i Mbrojtjes.

16 Përpara se të bëjmë ndërprerjen për pushimin, Trupi  
17 Gjykes mund të lejojë pyetje plotësuese.

18 Zoti Prokuror, dëshironi që t'i bëni pyetje plotësuese  
19 dëshmitarit?

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, Prokuroria  
21 nuk ka pyetje plotësuese për dëshmitarin.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
23 Faleminderit shumë.

24 Mbrojtësja e Viktimave, dëshironi të bëni pyetje shtesë?

25 ZNJ. PUES: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, por shumë



1 pak, shumë shkurt. Besoj se mund t'i bëjmë para se të bëjmë  
2 ndërprerjen për pushimin.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
4 keni fjalën, mundet.

5 ZNJ. PUES: [Përkthim]

6 Pyetje të mëtejshme nga Mbrojtësja e Viktimave:

7 Py. Zoti Sopi, mirëdita. Sigurisht, po përqendrohemi te  
8 periudha mars-prill e vitit 1999. Si ishin ato ditë, ishin  
9 shumë të ngarkuara dhe të vështira apo ishin ditë të qeta?

10 Pë. Ishin shumë të ngarkuara, nuk kanë qenë ditë të qeta.

11 Ditë të qeta në periudha lufte nuk ka pasur kurrë.

12 Py. Faleminderit. Dhe nga gjithçka që thatë më parë, e kuptoj  
13 se mbrojtja e popullatës civile kosovare ishte një pjesë e  
14 rëndësishme dhe pak më parë dëgjuam, kur u bë pyetja nga  
15 Avokati i Mbrojtjes që ju udhëhiqnit punën në Brigadën 153 në  
16 lidhje me mbrojtjen civile.

17 Në lidhje me këtë, a keni rënë ndonjëherë në kontakt me  
18 popullatën civile kosovare gjatë asaj periudhe?

19 Pë. Sigurisht, po.

20 Py. Faleminderit. Për shembull, njerëzit ju kanë kërkuar  
21 ndihmë? Flasim për civilë, sigurisht. Pra civilë, a ju kanë  
22 kërkuar ndonjëherë mbështetje, ndihmë, asistencë apo t'ju jenë  
23 drejtuar me pyetje të çfarëdo lloji në përgjithësi?

24 Pë. Po ne të gjithë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës  
25 në atë kohë jemi vënë në shërbimit të sistemimit, të pritjes,

1 sistemimit dhe kujdesit për qytetarët tanë, të cilët dhunshëm  
2 kanë qenë të përzënë nga Prishtina, Podujeva dhe rrethinat e  
3 tyre, dhe u jemi përgjigjur me aq sa kemi pasur mundësi në  
4 ofrimin e ushqimeve. Mirë e kujtoj se ne si ushtarë të  
5 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kemi pasur marrë vendim që një  
6 shul mos ta hamë ne, por t'ja japim popullatës civile.  
7 Domethënë, në vend se kemi hangër tre herë ushqim, ne një shul  
8 e kemi ndalë vetes dhe ja kemi dhënë popullatës civile. Të  
9 gjitha rezervate që i kemi siguruar ne për nevojat e luftës në  
10 atë kohë, i kemi lëshuar në shërbim të popullatës civile dhe i  
11 kemi dedikuar asaj.

12 Py. Faleminderit. ju falënderoj për përgjigjen, por shkurt,  
13 me "po" ose me "jo", mund të them që "po", ishit në kontakt me  
14 popullatën civile dhe ju janë drejtuar për ndihmë. Pra besoj  
15 se përgjigja për këtë është "po".

16 Pë. Po.

17 Py. Mirë, në rregull. A është po ashtu e vërtetë se ju  
18 personalisht keni probleme me emrat, që të mbani mend emrat,  
19 siç e thatë edhe dje në mëngjes, që është transkriptimi i  
20 datës 18 janar, faqja 52, rreshtat 19 dhe 20?

21 Pë. Nuk ka pyetje?

22 Py. Ah, po, pyetje. A është e vërtetë, që ju vetë i keni  
23 problem emrat?

24 Pë. Po.

25 Py. Faleminderit. Duke qenë se është kështu, a mund të

1 përjashtoni mundësinë që mund të keni harruar emrat e disa  
2 prej civilëve, me të cilët keni pasur kontakt gjatë periudhës  
3 mars apo prill 1999?

4 Pë. Unë gjatë asaj periudhe kam pasur kontakt me shumë  
5 ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me shumë civilë dhe  
6 --

7 Py. Zoti dëshmitar, ju lutem fokusohuni te pyetja ime. Është  
8 shumë e thjeshtë, "po" ose "jo". Pra duke qenë se është  
9 kështu, a mund të përjashtoni mundësinë që mund të keni  
10 harruar emrat e disa civilëve me të cilët mund të keni pasur  
11 kontakt gjatë asaj kohe?

12 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse --

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Hiqini dëgjueset ju lutem.

15 Zoti Avokat? Kuptoj që keni kundërshtim?

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Kjo pyetje, nuk e di nëse mund të  
17 lejohet kjo pyetje. Pra a mund të përjashtohet -- çdo gjë mund  
18 të përjashtohet, në çdo rast, prandaj është më mirë që të  
19 bëhet pyetje çfarë mban apo çfarë nuk mban mend, se me këtë  
20 mënyrë -- se nuk mund të përjashtosh asnjë mundësi në jetë.  
21 Është një pyetje shumë e përgjithshme dhe është e  
22 papërshtatshme.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

24 çfarë përgjigje keni?

25 ZNJ. PUES: [Përkthim] Kemi dëgjuar shumë pyetje që marrin

1 përgjigjen me "po" ose me "jo", janë pyetjet që i ka bërë  
2 Avokati i Mbrojtjes dhe për këtë arsye unë nuk e kuptoj këtë  
3 kundërshtim ndaj një pyetje që merr përgjigje me po ose me jo  
4 dhe që mbyll disa pyetje të cilat janë të përgjithshme për t'i  
5 ngushtuar gjërat që, gjithsesi do të ishin sugjeruese.

6 Unë po e mbyll dhe po sqaroj gjëra të cilat janë me  
7 rëndësi, siç kanë dalë nga pyetjet që i ka bërë Avokati i  
8 Mbrojtjes. Për këtë arsye mendoj se është në të drejtën time,  
9 madje në misionin tim që të kontribuoj në gjetjen e së  
10 vërtetës, për të kuptuar më mirë disa gjëra të qarta dhe të  
11 paqarta, sa i takon dëshmisë së dëshmitarit.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
13 fakt përgjigjen e dëgjuam dhe unë këtë pyetje do ta lejoj  
14 sepse ishte ngritur mirë, me përgjegjësi dhe duke u ngushtuar  
15 pastaj.

16 Mund të vazhdoni.

17 ZNJ. PUES: [Përkthim] Pra siç e thatë edhe ju, ne e  
18 dëgjuam pyetjen, ishte pyetja ime e fundit dhe këtu mbyllen  
19 edhe pyetjet e mia. Ju falënderoj edhe juve, Zoti dëshmitar.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 [Mikrofoni çaktivizuar].

22 Zonja Mbrojtëse e Viktimave, keni më pyetje?

23 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, faleminderit, të nderuar

24 Gjykatës, i kam mbaruar pyetjet.

25 Py. Faleminderit edhe juve, zoti Sopi, për përgjigjet.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] I  
2 afrohemi orës 11.

3 Zoti Sopi, do të bëjmë pauzën prej gjysmë ore. Në 11:30  
4 do të rifillojmë dhe atëherë do të vazhdojmë, pas asaj kohe.

5 Në rregull. Po e ndërpresim këtu deri në orën 11:30.

6 [Dëshmitari largohet nga salla e gjyqit]

7 --- Pauza filloi në orën 10:59

8 --- Seanca rifillon në orën 11:29

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të  
10 shohim praninë.

11 Atëherë shkurtimisht po shoh që ZPS-ja është e pranishme  
12 me të njëjtën përbërje siç edhe më parë. Vërej që Prokurori e  
13 pohon këtë gjë.

14 E njëjta gjë është e vërtetë edhe për Avokatin e  
15 Viktimave dhe për Avokatin e të Akuzuarit.

16 Z. Prokuror, fjala për juve.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, n.q.s.  
18 mund t'ju kërkoj që të bëj një pyetje në pyetjet plotësuese. E  
19 di që ka kaluar koha, megjithatë ne bëmë një konsultim të  
20 shkurtër ndërmjet kolegëve, pra gjatë pushimit të kafes dhe na  
21 ka mbetur edhe një pyetje. Kështu që n.q.s. është e mundur do  
22 të donim t'ju kërkonim që të bënim një pyetje plotësuese.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pa  
24 problem. Pasi të ketë ardhur në sallë dëshmitari, sigurisht  
25 d.m.th. që mund ta bëni pyetjen.

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit shumë. E vlerësoj.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

3 Sekretare, ju lutem a mund të shoqëroni dëshmitarin në sallë.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

6 se erdhët z. Sopi.

7 DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani

9 do të vazhdojmë me marrjen në pyetje.

10 I kërkoja Prokurorisë që të thoshte n.q.s. kishte ndonjë

11 pyetje për juve më përpara dhe në atë kohë ata nuk është se

12 kishin ndonjë pyetje. Ndërkohë që aktualisht ka një pyetje për

13 juve, kështu që do t'ju lejoj atyre t'ju bëjnë një pyetje dhe

14 pastaj do bëjmë sërish raundin dhe do përfundojmë me pyetjen e

15 Gjykatësve. E kuptuat këtë z. Sopi?

16 Në rregull.

17 Z. Prokuror, fjala për juve.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

19 Gjykatës.

20 Pyetje vijuese nga z. Michalczuk:

21 Py. Z. Sopi mirë se erdhët. Kam në fakt vetëm një pyetje për

22 ju dhe do të përpiqemi që të sqarojmë një prej përgjigjeve që

23 ju keni dhënë paraditen e ditës së sotme.

24 Në faqen 26, rreshti nga 10 deri në 12 i transkriptit të

25 ditës së sotme - pra ju është bërë një pyetje nga z. von Bone

1 edhe ju jeni përgjigjur rreth një vendi ku ju keni mbajtur  
2 personat e plagosur dhe të sëmurë në Zllash. Dhe pyetja e z.  
3 von Bone ishte se sa larg ishte ky vend nga shkolla ku  
4 mbaheshin personat e plagosur dhe të sëmurë. Dhe përgjigjja që  
5 ju dhatë ishte që distanca ishte 1 kilometër. A e konfirmoni  
6 këtë gjë?

7 Pë. Nuk e kam mat z. Prokuror, afërsisht kam thanun. Nuk jam  
8 i sigurt me - saktësisht nuk e di.

9 Py. E kuptoj. Pyetja ime është kjo. Sa larg ishte ky vend ku  
10 mbaheshin personat e sëmurë dhe të plagosur nga kompleksi që  
11 përdorej nga njësia BIA.

12 Pë. Edhe ajo mund të jetë rreth 2 kilometra.

13 Py. Në drejtim të shkollës apo jo? Për shembull n.q.s. do ta  
14 marrim si pikënisje kompleksin e njësitetit BIA, në cilin  
15 drejtim shkohet në mënyrë që të shkoni tek ky vendi, tek kjo  
16 shtëpia që trajtoheshin personat e sëmurë dhe të plagosur?

17 Pë. Në drejtim të jugut nga fshati.

18 Py. Shumë faleminderit. Nuk kam pyetje të tjera z. Sopi.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
20 Gjykatës.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Faleminderit, z.  
22 Prokuror.

23 Avokate e Viktimave besoj që ju i bëtë pyetjet tuaja.

24 Keni pyetje të tjera?

25 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, nuk kam pyetje të tjera.

1 Faleminderit shumë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
3 mirë.

4 Avokati Mbrojtës, nuk e di n.q.s. keni ndonjë pyetje  
5 tjetër plotësuese?

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës, nuk kemi  
7 pyetje të tjera.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
9 Sopi, ju janë bërë shumë pyetje nga Prokuroria, nga Mbrojtja e  
10 Viktimave dhe Mbrojtja e të Akuzuarit. Ndërkohë që tani  
11 Gjykatësit dëshirojnë t'ju bëjnë disa pyetje të tjera shtesë,  
12 në mënyrë që të sqarohen disa pika. Dhe do të na ndihmoni  
13 nëpërmjet përgjigjeve tuaja që të jemi më të qartë lidhur me  
14 gjërat që keni thënë. Pra në këtë mënyrë neve do të kuptojmë  
15 pak më mirë disa prej çështjeve të cilat janë trajtuar gjatë  
16 ditës së djeshme dhe ditës së sotme.

17 Pyetje nga Trupi Gjykses:

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
19 Atëherë ka dy tema që do të doja të trajtoja me ju. Pra  
20 vendndodhja e njësimit BIA.

21 Dje ju dhatë dëshmi lidhur me vendndodhjen e njësimit BIA  
22 në Zllash. Dhe për procesverbal, ky është transkripti në kohë  
23 reale në faqen 22, rreshtat nga 1 deri në 7. Dhe pyetja që kam  
24 për ju z. Sopi është kjo. Pse përdorte njësiti BIA fshatin  
25 Zllash për vendndodhjen e këtij njësiti?



1 Pë. Unë mendoj se njësitë BIA e përdorte këtë bazë të  
2 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, këtë shtëpi si bazë të vetën,  
3 për arsye se zhvillimin e aktiviteteve të tyre ata nuk mund ta  
4 zhvillonin në Prishtinë prej nga vinin shumica ose të them të  
5 gjithë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që ishin të  
6 radhitur në radhë të njësisë BIA. Në pamundësi që të jenë ata  
7 të sigurt në Prishtinë sepse Prishtina asokohe kontrollohej  
8 nga forcat ushtarake dhe policore serbe, ata shfrytëzuan këtë  
9 pikë për qëndrimin e tyre.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Çfarë  
11 kishte kaq të veçantë rreth kësaj baze, këtij vendi, kësaj  
12 vendndodhjeje?

13 Pë. Unë mendoj se asgjë nuk ka pasur të veçantë, por ajo ka  
14 qenë një nga bazat sikur të gjitha bazat e tjera të Ushtrisë  
15 Çlirimtare të Kosovës.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
17 rregull. Le të kalojmë te deklarata që i keni dhënë ZPS-së dhe  
18 për procesverbal do përmend deklaratën. Është deklarata me  
19 numër identifikimi ERN 06974-TR-ET [sipas përkthimit], Pjesa 2  
20 në faqen 20 dhe fillon te rreshti 13. Do ta lexoj për juve dhe  
21 do përkthehet ndërkohë. Por thjesht kërkoja që të jepej në  
22 ekran në mënyrë që të mund ta kontrollonin palët e tjera.

23 Pyetja është kjo:

24 "Pse përdorte BIA fshatin Zllash?"

25 Dhe përgjigjja që ju jepni është:

1 "Mendoj sepse ishte në një distancë nga ku ishin ata dhe  
2 se ishte lart në mal. Mendoj për çështje sigurie për ushtarët  
3 e tyre."

4 A mund të na e sqarosh pak më shumë këtë pjesën që ka të  
5 bëjë me "lart në male", çfarë donit të thonit me këtë që ishte  
6 lart në mal?

7 Pë. Lart në mal, kam menduar distanca nga Prishtina. Është  
8 përdorur d.m.th. distanca nga Prishtina lart, d.m.th.  
9 lartësia, se Zllashi si fshat është lart d.m.th. 1,210 metra,  
10 lartësi mbi detin, këtu kam mendu. D.m.th. distanca nga  
11 Prishtina të jetë sa më larg në mënyrë që mos të jenë objekt i  
12 sulmeve të policisë serbe, përndryshe ushtarët e njësisë BIA,  
13 familjet e tyre i kanë pasë në Prishtinë dhe ka mund të jenë  
14 të rrezikuara edhe familjet e tyre po të dinin se pjesëtarët e  
15 familjeve të tyre janë pjesëtarë të UÇK-së.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
17 Sopi, përkthyesja ju kërkoi që të përsërisnit edhe një herë  
18 sesa metra është Zllashi mbi nivelin e detit. Me ç'kuptohet  
19 nuk e kanë kapur përkthyesit.

20 Pë. 1,210 metra lartësi mbidetare.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Faleminderit.

23 Pyetja ime është kjo - pse për shembull kjo zonë ishte e  
24 përshtatshme për njësinë BIA dhe jo për njësitë e tjera si për  
25 shembull për Brigadën 153? A nuk ishte çështje sigurie për

1 Brigadën 153?

2 Pë. 153, pikat kryesore i ka pasë në Zllash. Shtabi i

3 Brigadës 153 zakonisht tanë kohën ka qenë në Zllash.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra a

5 e kuptoj drejt që ju thoni që pozicioni i Zllashit ishte më i

6 sigurt për njësitet e UÇK-së në mënyrë të tillë që njësitë të

7 ishin më shumë të mbrojtura nga serbët, këtë po thoni?

8 Pë. Po, këtë e them. Në përgjithësi d.m.th. janë shfrytëzu

9 largësia dhe lartësia sa ma shumë që të jetë e pamundur

10 depërtimi i forcave serbe në mënyrë d.m.th. që të vëreheshin

11 sa ma lehtë, fillimi i ndonjë ofensive nga forcat serbe.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit për përgjigjen. Po për mua nuk është ende e

14 qartë, sepse kur u pyetët nga ZPS-ja sepse BIA përdorte

15 Zllashin, ju thatë që ishte lart në mal. Dhe në këtë pikë

16 d.m.th. ju nuk është se keni përmendur ndonjë njësi tjetër që

17 ishte i stacionuar atje.

18 Pë. Nuk kam qenë i pyetur se përndryshe Brigada 153 e ka pasë

19 shtabin në Zllash.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit për këtë, z. Sopi.

22 Tani le të kalojmë tek i njëjti dokument që kemi këtu,

23 por në faqen 16 kësaj here, rreshti 2, faqja 16.

24 Znj. Sekretare nuk e di n.q.s. mund të na ndihmoni me

25 këtë.

1 Pyetja këtu është:

2 "Kur filloi nga puna BIA, pra prania e BIA-s në Zllash"?

3 Dhe përgjigjja është:

4 "Që ata kanë ardhur më herët në atë vend por ata e

5 përdorën atë si bazë në mënyrë të tillë që të mos

6 zbuloheshin në qytet".

7 Pyetja e parë është kjo, kur thoni "në qytet" cilit qytet

8 i referoheni? Për cilin qytet e keni fjalën?

9 Pë. Prishtinën.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Dhe këtu keni

11 përdorur fjalën "zbuloi" pra që të mos zbuloheshin në qytet. A

12 e kuptoj drejt që e keni pasur fjalën që është një mënyrë për

13 tu fshehur nga serbët? Për këtë e kishit fjalën?

14 Pë. Për këtë, po.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për

16 ta kuptuar unë, Zllashi ishte zgjedhur për arsye specifike,

17 ishte zgjedhur Zllashi, n.q.s. e kuptoj drejt, thjesht po bëj

18 një përmbledhje të asaj çfarë thatë juve për të parë n.q.s. e

19 kam kuptuar siç duhet atë çfarë thatë ju, se nuk dua që t'ju

20 keqinterpretoj. Pra arsyeja për zgjedhjen e Zllashit ishte

21 vendndodhja e Zllashit që ishte lart në mal dhe që ishte larg

22 Prishtinës? A është e saktë kjo?

23 Pë. Po, e saktë. E saktë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jua

25 bëra këtë pyetje, sepse në një moment të mëparshëm ju thatë që

1 mund të ishte zgjedhur çdo qytet ose qytezë tjetër, çdo vend  
2 tjetër përveç Zllashit. Por tani e kuptoj d.m.th. që mjedisi  
3 ose pozicioni gjeografik, mjedisi i Zllashit ishte arsyeja që  
4 pse ishte zgjedhur Zllashi.

5 Pë. Po, e vërtetë është.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Faleminderit që na e sqaruat këtë.

8 Kam edhe një temë tjetër. Kjo temë ka të bëjë me  
9 ofensivën e dytë, e cila ka ndodhur në gjysmën e dytë të  
10 prillit të vitit 1999.

11 Serbët a arritën që të futeshin në Zllash në ofensivën e  
12 dytë?

13 Pë. Po.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e

15 dini ju se kur ndodhi që serbët u futën në Zllash, jo kur  
16 ndodhi ofensiva e dytë, po kur në çfarë kohe d.m.th. u futën  
17 serbët në Zllash?

18 Pë. Unë besoj se ofensiva ka fillu më 18 prill, tri ditë ne  
19 kemi rezistuar dhe nuk kemi lejuar depërtimin e tyre në  
20 Zllash. Dhe në fund të ditës së tretë d.m.th. kur popullata  
21 civile është tërhequr në drejtim të Prishtinës dhe pasi që nga  
22 granatimet e vazhdueshme ne kemi pasur humbje edhe të  
23 ushtarëve tanë edhe nga popullata civile, ne jemi detyruar që  
24 t'i lëshojmë pikat tona në kuptimin që kanë filluar depërtime  
25 me tankse dhe mjete të rënda në drejtim të Zllashit dhe ata

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 54

Pyetje nga Trupi Gjykses

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 kanë arritur që ta pushtojnë Zllashin.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra

3 n.q.s. do përcaktojmë një datë, ju thatë ditën e tretë dhe

4 n.q.s. numërojmë nga data 18 i takon në datë 20 prill apo jo?

5 Pë. 20 të prillit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Para

7 apo pas?

8 Pë. Mund të jetë 20 ose 21 prill.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Faleminderit, z. Sopi.

11 A e dini ju se ku shkuan serbët në momentin kur u futën

12 në Zllash?

13 Pë. Serbët i dogjën së pari të gjitha shtëpitë dhe shkuan

14 pothuajse në çdo shtëpi në Zllash. Së pari, granatuan shkollën

15 me artileri dhe shtëpitë që dukeshin nga kodra në lartësi në

16 majën e Zllashit të Vogël filluan granatimet me trupa nga

17 tankset. Pastaj ka filluar depërtimi i këmbësisë së tyre dhe

18 kanë depërtuar pothuajse në të gjitha shtëpitë në Zllash.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

20 arritën serbët të shkonin në vendin ku gjendej njësitit BIA, në

21 kompleksin e njësitit BIA, në shtëpinë e familjes Krasniqi?

22 Pë. Po.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e

24 dini ju se çfarë bënë serbët atje?

25 Pë. Jo, nuk e di se nuk kemi pasë mundësi ta dimë. Vetëm se e

1 dimë se i dogjën të gjitha shtëpitë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A i  
3 dogjën dhe shtëpitë në atë vend?

4 Pë. Pjesën dërrmuese, ka mund të shpëtojë ndonjë, por pjesën  
5 dërrmuese i dogjën.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por  
7 n.q.s. më kujtohet mirë neve pamë një fotografi edhe dje edhe  
8 sot dhe ju na thatë që ky është vendi për të cilin ne po  
9 flasim dhe që ju thatë që këto shtëpi nuk janë djegur.

10 Pë. Ajo pjesë nuk është djegur, nuk ishte djegur, ndërsa  
11 pjesa e shtëpive në anën tjetër tërësisht kanë qenë të  
12 djegura, sepse ka pasur edhe shtëpi të tjera aty.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
14 Faleminderit. A keni ju njohuri n.q.s. ata shkuan në  
15 vendndodhjen e njësimit BIA me artileri ushtarake të rëndë për  
16 shembull me tanke?

17 Pë. Saktë me çfarë forcash nuk e di kanë depërtu, por e di, e  
18 di se kanë depërtu deri në çdo pikë të Zllashit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
20 thatë më parë, pra dëgjova që ju thatë se serbët iu afruan  
21 Zllashit edhe me tanke - a është e mundur që të shkohet në  
22 vendndodhjen e njësimit BIA atje lart me tanke për shkak të  
23 zonës, sepse i takon që është sipër në mal?

24 Pë. Është e kalueshme, ka rrugë, ka ara dhe kështu që ka qenë  
25 plotësisht e depërtueshme. Ka mund edhe me tankse, sepse

1 njerëzit qarkullojnë atje edhe me automjete. Nuk është se  
2 është mal i madh.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Çfarë  
4 bëtë ju? Ja një sekondë. A mund të themi që ata e okupuan në  
5 fund Zllashin, pra serbët a e okupuan Zllashin në fund?

6 Pë. Po.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ku  
8 shkuat ju atëherë?

9 Pë. Pjesa dërrmuese e brigadës ka qenë në regjionin e  
10 Koliqit.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po. A  
12 do të thuash që ju shkuat në Koliq?

13 Pë. Unë personalisht jo. Me një grup ushtarësh nuk kam  
14 lëvizur nga Zllashi.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ku  
16 qëndruat ju në atë kohë, në atë moment specifik?

17 Pë. Në mal, në pyll.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të  
19 citoj deklaratën që i keni dhënë ZPS-së për procesverbal dhe  
20 gjithashtu dhe mund ta shfaqim në ekran sa për tu siguruar që  
21 kemi citimin e duhur. Është dokumenti me numër identifikimi  
22 ERN 06974-TR-ET [sipas përkthimit], pjesa 3 dhe është faqja 14  
23 e kësaj deklarate. Në rreshtin 3 ju thoni:

24 "Ne qëndruam në Zllash, po ne nuk qëndruam me forcat  
25 serbe. Ne lëvizëm. Ne shkuam në pyll".



1 Kur thua që shkuam sepse ju përmendët fjalën pyll më  
2 përpara ndërkohë që këtu thuhet shkuam në mal. A do të thuash  
3 që mali dhe pylli është e njëjta gjë?

4 Pë. E njëjta gjë. Po, e njëjta gjë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra e  
6 kemi pasur një diskutim rreth këtij termi dhe më përpara.

7 D.m.th. keni qëndruar në bjeshkë, në bjeshkë duke u fshehur  
8 nga serbët?

9 Pë. Po, normal.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra  
11 keni qëndruar atje në bjeshkë? Po më pas çfarë bëtë?

12 Pë. Në shtëpi, e cila nuk ishte diktuar nga serbët dhe kishte  
13 shpëtuar e padjegur, e cila po ashtu ndodhej në pyll, në mal.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] T'i  
15 kthehemi sërish për një moment vendndodhjes së njësitit BIA në  
16 Zllash. Ju thatë që serbët shkuan deri atje. E kuptova drejt  
17 këtë?

18 Pë. Po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: A mund të na  
20 thoni se kur ka ndodhur kjo në kohë?

21 Pë. Të thashë ditën 20 ose 21 prill.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e  
23 kuptova drejt që përveç djegies së njërës pjesë - ose më  
24 lejoni ta formuloj ndryshe. Ju personalisht a keni qenë aty, a  
25 e keni parë me sytë tuaj se çfarë kanë bërë në momentin që

1 është bërë djegia?

2 Pë. Jo, s'kemi mund të afrohem ne.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra  
4 ju keni parë vetëm rezultatin, pasojën pas?

5 Pë. Vetëm pasojën dhe krismat, zhurmat d.m.th. granatimet,  
6 bombardimet i kemi vërejt prej distance, jo afër.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
8 rregull. A kishte ende ushtarë të njësitit BIA atje? A je në  
9 dijeni të kësaj?

10 Pë. Jo, nuk kam parë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
12 faleminderit, z. Sopi. Do konsultohem me kolegët e mi për të  
13 parë n.q.s. ata kanë pyetje të tjera për juve.

14 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
16 Kolegu në të majtën time ka një pyetje tjetër shtesë për ju.

17 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Z. Sopi, ju thatë se UÇK-ja  
18 shkoi në Zllash se ndihej e mbrojtur atje. N.q.s. e kuptova  
19 siç duhet vendndodhja e njësitit BIA ishte...

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
21 kërkoi ndjesë se humbëm lidhjen me z. Mustafa.

22 [Vështirësi teknike]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
24 Mustafa, më dëgjon?

25 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, znj. Gjykatëse.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
2 humbëm lidhjen me ju sërish. A më dëgjove mua të bëj pyetjen e  
3 fundit dhe përgjigjen e z. Sopi në pyetjen time?

4 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Unë ju dëgjova deri në  
5 momentin kur filluat me u konsultu me Panelin. Aty humbi  
6 lidhja.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
8 Faleminderit z. Mustafa.

9 Mirë atëherë, do t'i kërkoj kolegut tim në të majtën time  
10 që të përsërisë dhe një herë pyetjen se ishte në mes të  
11 pyetjes. Pra nuk keni humbur asgjë dhe nuk na duhet të lexojmë  
12 nga procesverbali.

13 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit. Do ta përsëris  
14 edhe njëherë pyetjen duke shtuar edhe një fjalë.

15 Z. Sopi, ju thatë që UÇK-ja kishte shkuar në Zllash sepse  
16 ndiheshin të mbrojtur atje për shkak të vendndodhjes së  
17 fshatit. Por n.q.s. e kuptoj siç duhet vendndodhja e BIA-s  
18 ishte edhe më lart në bjeshkë. A e kuptoj saktë si rezultat që  
19 në Zllash njësia më mirë e mbrojtur ishte njësitit BIA?

20 Pë. Nuk e di a ishte më e mbrojtur apo jo, por pjesë e  
21 Zllashit është pjesa ma e lartë ajo ku ndodhet, ku ndodhej  
22 njësitit BIA. Nuk është se është kërkuar që ajo të jetë më e  
23 mbrojtur se pjesë të tjera por ka ndodhë shtëpi e lirë dhe na  
24 u ka dhënë në shfrytëzim. Nuk ka pasë ndonjë diçka specifike  
25 që të sigurohet një bazë specifike për dikënd specifik, nuk ka

1 pasë.

2 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull, por kjo shtëpi ku  
3 ndodheshin ata ishte më e vështirë për t'u arrit sesa shkolla  
4 apo jo, ta zëmë për shembull?

5 Pë. Veç ishte më lart pak, në distancë rreth 1 kilometër e  
6 gjysmë, 2.

7 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra ishte më e vështirë për  
8 tu arritur?

9 Pë. Po.

10 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Gjatë ofensivës serbe,  
11 ofensivës së dytë që filloi më 18 prill, ju thatë se shkuat në  
12 bjeshkë. Kur u kthyet pastaj? Sa ditë qëndruat në bjeshkë edhe  
13 kur u kthyet në Zllash? Cilën datë mbani mend?

14 Pë. Ne u kthyem pas tërheqjes së forcave serbe dhe u vendosëm  
15 në shtëpinë që ceka më parë, po ashtu ishte në pyll.

16 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Kur patë përsëri pas sulmit  
17 serb, pas tërheqjes serbe? Kur e patë përsëri shtëpinë ku  
18 ndodhej BIA dhe shkollën?

19 Pë. Pas disa dite. Ne s'kemi mujt me depërtue. Nuk kemi mujt  
20 d.m.th. me i vizitu ato pika sepse kanë qenë të djegura krejt  
21 të shkatërruara.

22 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Mirë, faleminderit shumë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kemi  
24 arritur kështu në fund të dëshmisë suaj. Ju falënderoj shumë  
25 për përpjekjet që keni bërë për të dhënë dëshminë përpara

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 61

Pyetje nga Trupi Gjykues

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 këtij Trupi Gjykues, për të na ndihmuar në punën tonë për të  
2 gjetur të vërtetën.

3 Ju falënderoj shumë. Ky është fundi i qëndrimit tuaj këtu  
4 në sallë. Ju uroj udhëtim të mbarë për në shtëpi. Ju rikujtoj  
5 se nuk duhet të diskutoni për dëshminë që keni dhënë këtu  
6 përpara këtij Trupi Gjykues me askënd. Kështu pra, rrugë të  
7 mbarë. Faleminderit.

8 DËSHMITARI: Faleminderit. Faleminderit. Punë të mbarë dhe  
9 juve. Ditën e mirë.

10 [Dëshmitari largohet]

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit znj. asistente e sallës që e shoqëruat  
13 dëshmitarin për të dalë edhe pse unë nuk jua kërkoja.

14 Shumë mirë atëherë. Do të pyes palët e pjesëmarrësve nëse  
15 kanë diçka për të thënë në këtë moment.

16 Z. Prokuror.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nuk kemi as pyetje as komente  
18 nga ana e Prokurorisë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Znj. Mbrojtëse e Viktimave, keni fjalën.

22 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit. Asgjë dhe nga ana  
23 jonë për të shtuar.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

25 Avokat i Mbrojtjes keni fjalën.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të thënë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
3 mirë.

4 Duke qenë se nuk ka asgjë tjetër për t'u ngritur nga  
5 palët dhe Mbrojtësja e Viktimave, do të rifillojmë seancën  
6 ditën e martë, 25 janar, javën e ardhshme në orën 9.30 me  
7 dëshminë e Dëshmitarit 4484.

8 Falënderoj palët dhe Mbrojtësen e Viktimave për  
9 pjesëmarrjen. Falënderoj stenografen, përkthyesit, personelin  
10 audio-viziv dhe personelin e sigurisë për asistencën.

11 Këtu mbyllet seanca.

12 --- Seanca mbyllet në orën 12.05

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25